



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO



REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër: 644/01-65753, datë: 31.Maj 2018.

Në bazë të nenit 11, nenit 12 al.2.pika d) dhe nenit 40. paragrafi 2 pika h) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28. datë: 04.qershor 2008”), nenit 2, nenit 3 paragrafi 3.6 dhe nenin 6 paragrafi 6.8 të Rregullorës Nr.02/2016 për tituj të nderit, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falenderime I.Nr.400-19443 dt.01.prill 2016, dhe nenit 8 të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29 Shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në Propozimit të Komisionit të Kuvendit dhe në Rekomandim të KPF-ca, në takimin e mbajtur me datë: 31.Maj 2018, miratoi këtë:

V E N D I M

Nr.31/2018

Për nderim me “Mirënjohje Komunale ” znj. Mrika Nikqi

1.Znj.Mrika Nikqi, nga Peja nderohet me “Mirënjohje Komunale” të Komunës së Pejës, me motivacion:

“Ka treguar suksese të jashtëzakonshme në alpinizëm për moshën e saj 16 vjeçare duke u ngjitur në majet më të larta në vend dhe të botës përfshirë majen e famshme të Kelimanxharos në Afrikë. Me këto aktivitete e ka nderuar Pejën dhe i ka promovuar vlerat e rinisë dhe sportit Pejan. ”

2.Në bazë të këtij vendimi do t’i dorëzohet “Mirënjohje Komunale” dhe i bëhet organizimi i ceremonisë për dorëzimin e mirënjohjes konform nenit 4 të Rregullorës Nr. 02/2016.

3.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi i kuvendit komunal Pejë.

4.Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Web faqen zyrtare të Komunës.

Dorezohet:

1x1.MAPL.
1x1.Kryetarit të Komunës
1x1.DKRS
1x1.Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT
dr.Islam Husaj